Lezhë, më 28.08.2023

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 28.08.2023, në orën 12:00, në sallën e Bibliotekës "At Gjergj Fishta" Lezhë, për Rregulloren e Re të Strukturave Komunitare. Në takim morrën pjesë anëtarë të Këshillit të Bashkisë Lezhë, administratorë të njësive administrative të bashkisë, kryetarë të fshatrave, qytetarë, përfaqësues të projektit "Bashki të Forta".

- Fjalën e hapjes së takimit e mbajti Kryetari i Këshillit z. Ndue Luli i cili theksoi rëndësinë e kësaj rregulloreje dhe të miratimit të saj. Më pas i dha fjalën z. Agostin Marku, zv/kryetar.
- Agostin Marku: Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen në këtë takim konsultativ. Fakti i një pjesëmarrjeje të tillë tregon që ka interes, jo se nuk kemi pasë rregullore apo strukture komunitare nëpër fshatra, por edhe ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ka dhënë një autoritet tjetër dhe do ca rregullore dhe përcaktimin e disa kompetencave të cilat kërkojnë që të jetë një rregullore me sa më standarte ligjore dhe mbi të gjitha të jetë funksionale. Ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore" ka kohë që ka dalë por realisht në mandatin e parë pak ka gjetur zbatim për sa i përket mënyrës së konstituimit të strukturave komunitare, gjithashtu dhe në mandatin e

dytë, për arsye që dihen, sepse ishte vetëm një armë e politikës. N.q.s do kemi një strukturë komunitare të fortë dhe efektive, përpëtër dhe punët e bashkisë do të lehtësohen. Ne kemi ndërtuar një rregullore të re, kur është marrë për bazë një rregullore që ka sjellë projekti "Bashki të Forta", që gjej rastin t'i falenderoj për gjithë angazhimin dhe përkushtimin që kanë për t'i dhënë asistencën e duhur bashkive dhe këshillave vendore, në mënyrë që të kemi rezultatet e duhura në zbatim të ligjit 139/2015. Ne menduam t'ia përshtatim më mirë kushteve specifike që ka Bashkia Lezhë, për strukturat në fshat por edhe në qytet që deri më sot nuk funksionojnë në qytet por nga bisedat që kemi pasë, bashkia është shumë e vendosur që këto struktura të ngrihen dhe funksionojnë dhe në qytet. Në këtë rregullore është përcaktuar qartë mënyra e funksionimit të tyre në raport me bashkinë, këshillin e bashkisë, në lidhje dhe me sugjerimet që vijnë prej tyre direkt nga komuniteti. Është menduar dhe kyçështimi i disa procedurave që ishin në rregulloren e mëparshme. Jemi të gatshëm që deri kur të zhvillohet mbledhja të presim sugjerime, por mendojmë

që formë më e mirë është kjo që po bëjmë sot sepse një pjesë e mirë janë të zgjedhur nëpër fshatra, sepse ata i njohin problematikat shumë më mirë se ne që i kemi shkruar këtu nga ana teorike duke u mbështetur në ligjë dhe do ishte gjë shumë pozitive që ju të na jepni propozime konkrete që ne të bëjmë rregullimet e duhura. kështu ne i thjeshtojmë shumë procedurat, rrisim transparencën, rregullojmë raportet pozitë - opozitë nga këshilli për të ndjekur procesin e zgjedhjeve.
Falenderim të veçantë merr dhe z. Hekuran Koka si përfaqësues i projektit "Bashki të forte". i cili ka dhënë një kontribut të veçantë dhe për përgatitjen e rregullores së re. Uroj që bashkëpunimi i bashkisë, këshillit dhe strukturave komunitare të vazhdojë dhe më të ardhmen.

- Ndue Luli: Fjala është për ju për pyetje e diskutime.

- Arilda Llesh - pyetare - Edhe te rregullorja tjetër, edhe te drafti i ri që keni propozuar, mënyra si zgjidhet këshilli komunitar në qytet është pak ndryshe nga si zgjidhet kryesia e fshatit. Për këshill komunitar duhet të kalojmë dy procedura, një - duhet të mblidhen firmat e të certifikohen, pastaj duhen dhe zgjedhjet. ndërkohë që kryesia e fshatit kalon direkt

në zgjedhje. Kjo vetëm sa ia shton hapat ngutjes së këshillit komunitar dhe e vështirëson duke pasur parasysh që është vullnetare dhe e shoh si të panevojshme. Nuk e kuptoj pse në qytet duhet iniciativë qytetare kurse në fshat shkohet direkt në zgjedhje.

– Agostin Marku: Ashtu duket por realisht nuk është ashtu, sepse dhe në fshat, po ta shikosh mirë, e kemi në dy faza. Faza e parë është zgjedhja e anëtarëve të kryesisë së fshatit nëpër lagje. Lagjja në qytet është krejt tjetër me lagjen në fshat, kështu ka qenë dhe herën tjetër por nuk ka qenë e sanksionuar në rregullore. Ndërsa në qytet ka një veçori. Në qytet nuk zgjidhen përfaqësuesit nga komuniteti, por zgjidhen nga grupet e interesit, që kanë të drejtë të përfaqësohen dhe ata zgjedhin ndërlidhësin. Pra në qytet e ke emrin ndërlidhës, në fshat e ke kryetar i fshatit, por në të dy rastet është zbatuar ligji në ndërtimin e rregullores. Ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore" e ka të përcaktuar qartë që zgjedhjet për kryesitë e fshatrave bëhen jo më vonë se tre muaj pas zgjedhjeve për këshillin bashkiak. N.q.s do vazhdonim me rregulloren e vjetër, ky proces do zgjaste 1 ose 2 vjet. Një gjë tjetër e re

është te kriteret e përzgjedhjes. Kishte shumë bunoktaci sepse në ndonjë fshat ne do rrekomandonim pa kryetar fshati.

Pra, kemi bërë vetëm thjeshtim në mënyrë që të zgjidhen sa më shpejt strukturat, me transparencë të plotë dhe në shërbim të ligjit.

- (Vazhdoi diskutimi në lidhje me çështjen që pyetësorja shtroi, ku mori përgjigje nga z. Marku)

- Preng Gjoka (Kryetar i Fshatit Kalmet - Nj.A. Ungrej) -
  - Unë jam prej vitesh kryetar fshati dhe pjesë e zgjedhjeve nëpër logje është e njëjtë dhe pastaj mblidhen dhe zgjidhin kryetarin, pra me dy faza është. Unë jam shumë dakord. Nuk kam asnjë llaj shtese apo vërejtje.

- Gjergj Malshi (administrator Nj.A. Zejmen -
  - Unë e kam studjuar rregulloren. Është bërë një punë për t'u marrë shembull. Nisur dhe nga eksperienca ime që kam në qeverisjen vendore, dua të ndalem vetëm në një aspekt, te ushtrimi i detyrës së kryetarit të fshatit. Ka një praktikë të delegimit të kompetencave në mungesë për kryetarin e bashkisë, për administratorin. Ikën kryetari i fshatit, jashtë shtetit për 3 muaj dhe fshati mbetet jashtë mbulimit të nevojave që kanë banorët. Është një hallkë shumë e rëndësishme ushtrimi i detyrës së kryetarit të fshatit për qeverisjen vendore. Ai nuk mund

të largohet pa lejen e kryetarit të Bashkisë për periudha të tilla, dhe në rastin konkret, mendoj që në rregullore duhet përcaktuar. zëvendësimi me një anëtar të kryesisë së fshatit.

- Ndue Luli: Jam dakord me shpjegimin tuaj.
- Vasilike Leska (Organizata Përfshirja Sociale për Zhvillim) — A ke menduar këshilli Bashkiak se si do angazhojë banorët për zgjedhjen e këtyre strukturave sepse ne e dimë apatinë që kanë qytetarët pothuaj kur kemi zgjedhje vendore dhe qendrore, jo më një strukturë fshatar që shtohet, a mendoni që ka një model që ka treguar që të funksionojë kjo mënyrë zgjedhje që ju keni propozuar në këtë rregullore?
- Ndue Luli: Sot bëhet fjalë për konsultim për rregulloren. Në mbledhjen e këshillit Bashkiak pas pak ditësh do miratohet duke pasur parasysh të gjitha mendimet që janë dhënë, por në lidhje me këtë që thoni ju, nuk bëhet fjalë që do nisë që nesër procedura e zgjedhjeve, por do miratohet kjo rregullore dhe njoftimet do bëhen shumë herët në çdo lagje e fshat ose çdo lagje të qytetit, në media, në web-in e bashkisë dhe këshilli do përcaktojë komisionet përkatëse sipas njësive administrative, të përbëra nga 5 anëtarë nga pozita, opozita, bashkia dhe zgjedhjet do jenë ligjore n.q.s do marrin pjesë

50% +1 e komisionit.

- Agostin Marku: Diçka në lidhje me sensibilizimin e banorëve. E kemi sanksionuar në regullore, Pavarësisht se kur hyn në fuqi regullorja, në rastin konkret me shpejt do jetë për fshatin sepse do kohë emërimi i strukturave komunitare në pyjet. Ne kemi përcaktuar një muaj kohë që i lihet në dispozicion të gjithë strukturave, pra bashkisë, këshillit, administratës së njësisë vendore, kryetarit të fshatit aktual, për të sensibilizuar opinionin se është hapur fushata e zgjedhjeve për strukturat komunitare.

- Ded Doda (Kryetar i fshatit Zimaj - Nj. A. Ungrej) - Më përpara kryeplaku emërohej, fallsifikonin letrat, unë kam rastin tim. Kryeplaku është përfaqësues i popullit dhe zgjidhet me votë. Unë kishe dy sugjerime që për mue më e rëndësishme është që kur bëhet projekti për buxhetin, të na thërrisni për të diskutuar për se i përket zërave për investime në bashki se është ai koncepti që i jo, nuk të takon ty. Kaq kishe.

- Ndue Luli: Në lidhje me këtë, p/buxheti i bashkisë ka 3 fazat e veta, gjithashtu që kryetarët e fshatrave janë të përfshirë nëpërmjet konsultimeve publike. Vitet e kaluara besoj se shumë prej jush kanë qenë pjesëmarrës por

edhe sirjet do organizohen sipas njësive
administrative me pjesëmarrje, krahas web-it.

— Gjergj Figuri (pyetatar – Unioni i Gazetarëve) —
Lezha, përjashtuar lagjen "Nënë Tereza", ka
më së shumti pallate dhe grupet e interesit
mund të jenë drejtpërsëdrejti përfaqësuesit e
çdo pallati, për një arsye shumë të thjeshtë
sepse pallati përballë meje ka 124 hyrje ndërsa
pallati im ka 15. Mundësitë që përfaqësuesit të
jenë nga ai pallat është shumë më e madhe.
e në këtë mënyrë do ishte gjëja më e mirë që
përfaqësuesit e kësaj strukture të jenë përfaqë-
suesit e çdo pallati apo të një grupi shumë
të vogël pallatesh dhe ky mund të përbëjë
një grup interesi sepse është një grup interesi
direkt dhe është një mënyrë për të krijuar
një lloj balance ndërmjet disa objekteve që
janë shumë më të mëdha krahasuar me
disa të tjera dhe për të ndihmuar prezencën
e banorëve sepse jam i bindur që pallati
i madh me 120 hyrje s'do ketë kohë të
merret me pallatin tonë për gjëra të vogla.
E dyta, që ka të bëjë me kryetarët e fshatrave
Normalisht, kryetarët e fshatrave, duke qenë
të zgjedhur, nuk mund të marrin leje te
kryetari i Bashkisë se ku shkojnë, por mund
të sanksionohet në rregullore se kush është

zëvendësuesi i tij, apo në mungesë dhe të këtij të fundit se kujt i delegohen kompetencat deri në momentin që plotësohet

- Agostin Marku: Ne jemi pak mbrapa me strukturat komunitare në qytet dhe si mjedhin me dhe raportimi se si do funksionojnë dhe më lejoni të lexoj se si është konceptuar në rregullore, për mos të ngatërruar lagjen me pallatin apo me ato minilagjet që kemi në qytet (lexon përkufizimin në rregullore).
Pra jemi përpjekur të fusim moshën më aktive në strukturat komunitare.
E dyta, për sa i përket kryetarit të fshatit, Ne e kemi përcaktuar, mbas 6 muajsh, nëse mungon, bëhet zgjedhje e atij përfaqësuesit që mungon, pra edhe kur është kryetar i fshatit edhe kur është anëtar i kryesisë. Edhe kryetari i fshatit është zgjedhur si anëtar i kryesisë se po nuk ye nuk mund të jetë kryetar, prat edhe kur diçka nuk është e përcaktuar në rregullore, për besë merret rregullorja e këshillit të Bashkisë.

- Vladimir Paloka (Kryetar i fshatit Zejmen) — rregullorja duket mirë por puna jonë nuk është mirë, është pesimiste.
Ne duhet të bëjmë deklarim për dragës në fshat, po u fjet ne jemi në burg.

- Agostin Marku: ke plotësisht të drejtë. Ka një përpjesëtim të përcaktuar të shpërblimit në ligj dhe ne nuk mund ta ndryshojmë. Edhe kryetari i këshillit si çdo anëtar tjetër ka 10% të pagës së kryetarit të Bashkisë si shpërblim. Unë kam kërkuar me forcë që nga viti 2015 e këtej që veçanërisht për fshatrat e mëdhenj, shpërblimi që merr kryetari i fshatit të jetë barat me shpërblimin që merr këshilltari. Ligji është por mund edhe të përmirësohet. Ne do ta shikojmë. Është në vëmendjen edhe të aparatit të bashkisë.

- Xhemal Malecaj (kryetar i fshatit Malecaj, NJ.A. Balldre) – Unë jam dakord me ato që u thanë. Kjo punë është vullnetare, e dimë, por ju lutem ne shikoni çështjen e shpërblimit. Unë nuk e shikoj në ligj se një kryeplak do dalë të kontrollojë malet apo do hyjë në burg se mbajti tjetri drogë. Unë nuk jam roje.

- Alfons Frashej (anëtar i këshillit Bashkiak Lezhë) – Të zgjidhesh kryeplak dhe të bësh rolin e punonjësit të policisë është absurde, apo të jetë punë vullnetare për fshatin. Nuk ka një vend të Europës që të ketë punë vullnetare, të papaguara. Këta janë bërë zëvendës të policisë e prokurorisë.

- Agostin Marku: Një sqarim. Unë e shoh që ka shumë paqartësi sepse nuk njihen paketa ligjore dhe rregulloret. Unë shoh që pas këtyre zgjidhjeve këshilli duhet të punojë fort me trajnime me strukturat komunitare. Ju nuk mund të kthehemi bisht i strukturave të tjera, partner i tyre po, për t'i shërbyer zgjidhjes së problematikave e hallere që ka komuniteti. Duke njohur mirë bazën ligjore do përfitohen edhe për çështje të tjera që thoni.
Në lidhje me shpërblimet, ne do bëjmë mos të marrin që të shkojnë në nivelin maksimal që e përcakton ligji.
- Pjetër Noka (anëtar i këshillit Boshkiek Lethë) -
- Unë mendoj që duhet parë çështja e pagesës.
- Arilda Lleshi: U ngrit çështja e arrestimeve në rast të konstatimit të drogës dhe mendoj që nuk u dha një përgjigje e saktë.
Unë si pyetësore kam një pyetje - Cili ligj e rregullon këtë?
- Ndue Luli: Detyra jonë është ngritja e këtij problemi të shtruar nga kryetarët e fshatrave.
- Agostin Marku: Ne nuk jemi mbledhur sot për të bërë analizën e kësaj çështjeje. Ne jemi mbledhur sot për të bërë një konsultim publik për rregulloren e mënyrës

së funksionimit të strukturave komunitare, që e kemi mbështetur në një paketë ligjore. N.q.s për një të zgjedhur, Kuvendi i Shqipërisë, Qeveria, përcaktojnë ca akte ligjore e nënligjore dhe i jep detyra shtetësë, nuk jemi ne ata që i analizojmë, as nuk jemi këtu në konferencë shtypi për të folur për organe të tjera apo në emër të tyre që nuk jemi në kompetencën tonë. Ne kemi kompetencë të miratojmë një rregullore të bazuar në ligj. Ne nuk e shkruajmë dot në rregullore që kujdestari i fshatit nuk u përgjigjet strukturave të policisë sepse është shkelje. Ne shkruajmë ato që jemi në përputhje me pjesëmarrjen e komunitetit në qeverisjen vendore, me decentralizimin apo të tjera që ndikojnë në mbarëvajtjen e punëve në komunitet.

- Ndue Luli: Ju falënderoj shumë për pjesëmarrjen dhe të gjitha mendimet e dhëna nga ana juaj do mbahen parasysh nga ne.

SEKRETARI I K.B. LEZHE
FLORIDA ÇUNAJ